<p style="text-align: center;"><b>Neni 21</b> <b>Vendosja në treg e mjeteve matëse ligjërisht të kontrolluara</b></p> <p>1. Në Republikën e Kosovës mund të vendosen në treg dhe/ose të vihen në përdorim vetëm ato mjete matëse të cilat:</p> <p style="margin-left: 40px;">1.1. i plotësojnë kërkesat nga ky ligj; 1.2. i plotësojnë kërkesat tekniko metrologjike të përcaktuara me dispozita në zbatim të këtij ligji, si dhe; 1.3. i kanë kaluar procedurat e përcaktuara të vlerësimit të konformitetit.</p> <p>2. Prodhuesi, ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, është përgjegjës për kryerjen e procedurave të</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 21</b> <b>Placing on the market the legally controlled measuring instruments</b></p> <p>1. In the market of the Republic of Kosovo may be placed and/or made available for use only those measuring instruments which:</p> <p style="margin-left: 40px;">1.1. meet the requirements deriving from this law; 1.2. meet technical and metrological requirements determined with applicable provisions of this law, as well as; 1.3. have passed the determined conformity assessment procedures.</p> <p>2. Manufacturer, or his authorized representative, shall be responsible to carry out</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 21</b> <b>Plasiranje na tržište zakonski kontrolisanih merila</b></p> <p>1.Na tržište Republike Kosovo mogu da budu plasirani i/ili dostupni za upotrebu samo oni merila koji:</p> <p style="margin-left: 40px;">1.1.Ispunjavaju zahteve iz ovog Zakona; 1.2.Ispunjavaju tehničke i metrološke zahteve utvrđene važećim odredbama ovog zakona; 1.3. Su uspešno prošli utvrđene postupke procene usklađenosti.</p> <p>2.Proizvođač ili njegov ovlašćeni predstavnik je odgovoran za sprovođenje postupaka procene</p>



<p>vlerësimit të konformitetit dhe garanton se mjeti matës përputhet me kërkesat metrologjike të përcaktuara.</p> <p>3. Mjetet matëse të cilat i plotësojnë kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni, duhet që para se të vendosen në treg, të jenë të shënjuara me shenja të përshkruara të konformitetit dhe të përcillen me dokumente të konformitetit sipas dispozitave ligjore.</p> <p>4. Mjetet matëse në përdorim duhet të përdoren në përputhje me kërkesat për atë tip të mjetit matës, në përputhje me dokumentet e konformitetit dhe me udhëzimet e prodhuesit të mjetit matës.</p> <p>5. Mjetet matëse që nuk plotësojnë kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni, të cilat nuk janë shënjuar dhe nuk posedojnë dokumentet e konformitetit sipas kërkesave metrologjike, nuk lejohen të vendosen në treg dhe/ose të vihen në përdorim.</p>	<p>conformity assessment procedures and guarantee that the measuring instrument is in compliance with the determined metrological requirements.</p> <p>3. Before being placed on the market, measuring instruments that fulfil the conditions referred to in paragraph 1 of this Article should be marked with described conformity marks and be accompanied with conformity documents according to the legal provisions.</p> <p>4. Measuring instruments in use should be used in compliance with the requirements for that type of measuring instrument, in compliance with the conformity documents and instructions of the measuring instrument manufacturer.</p> <p>5. Measuring instruments that do not meet the conditions referred to in paragraph 1 of this Article, which have not been marked and possess no conformity documents according to the metrological requirements, shall not be allowed to be placed on the market and/or put into use.</p>	<p>usklađenosti i garantuje da su merila u skladu sa utvrđenim metrološkim zahtevima.</p> <p>3.Pre nego što se plasiraju na tržište, merila koji ispunjavaju uslove iz stava 1. ovog člana treba da budu označeni opisanom oznakom usklađenosti i treba da imaju u prilog dokumentaciju o usklađenosti u skladu sa zakonskim odredbama.</p> <p>4.Merila u upotrebi treba da se koriste u skladu sa zahtevima za taj tip merila, u skladu sa dokumentima o usklađenosti i uputstvima proizvođača mernih instrumenta.</p> <p>5.Merila koji ne ispunjavaju uslove iz stava 1. ovog člana, koji nisu označeni i ne poseduju dokumentaciju o usklađenosti u skladu sa metrološkim zahtevima, ne treba plasirati na tržište i/ili staviti u upotrebu.</p>
---	---	---

<p align="center"><b>Neni 22</b> <b>Shenjat e verifikimit</b></p>	<p align="center"><b>Article 22</b> <b>Verification marks</b></p>	<p align="center"><b>Član 22</b> <b>Oznaka o overavanju</b></p>
<p>1.Nëse mjetet matëse janë në pajtueshmëri me kërkesat e verifikimit fillestar dhe verifikimit pasues periodik, AMK ose trupat e autorizuar të vlerësimit të konformitetit, e vendosin në mjetin matës shenjën e verifikimit dhe lëshojnë certifikatën e verifikimit.</p> <p>2.Paraqitja grafike, dimensionet e shenjave të verifikimit dhe karakteristikat e certifikatës së verifikimit përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria.</p> <p>3. Shenja e konformitetit, shenja plotësuese e metrologjisë dhe shenjat/plombat siguroese të vendosura në mjetet e caktuara matëse, të cilat vendosen në treg sipas rregullores për mjete matëse dhe rregullores për peshoret joautomatike, konsiderohen të jenë shenja të konformitetit. Deklarata e konformitetit në këtë rast konsiderohet e barazvlefshme me certifikatën fillestare të verifikimit.</p> <p>4.Shenjat e metrologjisë - plombat që aplikohen në mjetet matëse, kanë të njëjtën mbrojtje ligjore sikurse çdo plombë në pajtueshmëri me ligjin përkatës të Republikës së Kosovës.</p>	<p>1. If measuring instruments are in compliance with the requirements of initial verification and subsequent (periodic) verification, KMA or authorized conformity assessment bodies, shall affix to the measuring instrument the verification mark and issue the verification certificate.</p> <p>2. Graphical representation, dimensions of verification marks and characteristics of the verification certificate shall be defined through a bylaw issued by the Ministry.</p> <p>3. Conformity mark, supplementary metrology mark and security marks/seals placed in certain measuring instruments, which are placed on the market in compliance with the Regulation for Measuring Instruments and Regulation for Non-Automatic Weighing Instruments shall be considered as conformity marks. Declaration of conformity in this case shall be considered equal to the initial verification certificate.</p> <p>4. Metrology marks – seals applied to measuring instruments shall have the same legal protection as each seal in compliance with therelevant lawof the Republic of Kosovo.</p>	<p>1.Ako su merila u skladu sa zahtevima inicijalno overavanja i naknadnog (periodičnog) overavanja, KAM ili ovlašćeno telo za procenu usklađenosti postavlja na marila oznaku o overavanju i izdaje uverenje o overavanju.</p> <p>2.Grafički prikaz, dimenzije oznake o overavanju i karakteristike uverenja o overavanju definiše kroz podzakonski akt koji donosi Ministarstvo.</p> <p>3. Oznaka usklađenosti, dodatna metrološka oznaka i oznaka/pečat o bezbednosti postavljena na određenim merila u skladu sa Uredbom o merila i Uredbom o ne-automatskim vaga se smatra i kao oznaka usklađenosti. Izjava o usklađenosti u ovom slučaju se smatra jednakom sa uverenjem o inicijalnom overavanju.</p> <p>4. Metrološke oznake – pečati postavljeni na merila imaju istu zakonsku zaštitu kao i svaki pečat u skladu sa relevantnim zakonom Republike Kosovo.</p>

<p>5.Mjetet matëse që nuk janë në konformitet me kërkesat ligjore të aplikueshme, shënjohehen si të refuzuara, dhe/ose largohen shenjat e verifikimit, apo detyrohen që të jenë në konformitet, të riparohen, ose të tërhiqen nga tregu.</p>	<p>5. Measuring instruments that are not in conformity with the applicable legal requirements, shall be marked as refused and/or verification signs shall be removed, or forced to be in conformity, repaired or withdrawn from the market.</p>	<p>5.Merila koji nisu u skladu sa važećim zakonskim zahtevima, označavaju se kao odbijeni i/ili se sa njih uklanja oznaka o overavanju, se zahteva usklađivanje, popravka ili povlačenje sa tržišta.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 23</b> <b>Personat përgjegjës për mjetet matëse ligjore në përdorim</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 23</b> <b>Responsible persons for the legal measuring instruments in use</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 23</b> <b>Lica odgovorna za zakonske merila u upotrebi</b></p>
<p>1. Përgjegjës për mjetet matëse ligjore në përdorim është shfrytëzuesi, i cili duhet:</p> <p>1.1. të përdorë vetëm ato mjete matëse të cilat janë të verifikuara;</p> <p>1.2. të mbajë mjetet matëse në gjendje teknike që këto të sigurojnë saktësi të matjes;</p> <p>1.3. të paraqes në verifikim mjetet matëse që janë në përdorim, në pajtim me këtë ligj;</p> <p>1.4. të përdorë mjetet matëse ligjore në përputhje me destinimin e tyre;</p> <p>1.5. të mbajë evidencë rreth mirëmbajtjes dhe verifikimit të mjeteve matëse ligjore në përdorim, kur kjo është e përcaktuar.</p> <p>2. Mjeti matës ligjor, që nuk është në përdorim, duhet të jetë i shënjuar në mënyrë të dukshme, me shenjën “Mjeti matës jashtë përdorimit”.</p>	<p>1. The user shall be responsible for legal measuring instruments in use and shall:</p> <p>1.1. use only measuring instruments that have been verified;</p> <p>1.2. keep measuring instruments in good technical conditions so they can ensure measuring accuracy;</p> <p>1.3. submit for verification measuring instruments in use, in compliance with this law;</p> <p>1.4. use legal measuring instruments in compliance with their destination;</p> <p>1.5. keep evidence about the maintenance and verification of legal measuring instruments in use, when this is defined.</p> <p>2. Legal measuring instrument that is not in use shall be visibly marked with the mark “Measuring instrument out of use”.</p>	<p>1. Korisnik je odgovoran za zakonske merila u upotrebi i:</p> <p>1.1.koristi samo merila koji su overeni;</p> <p>1.2.održava merila u dobrom tehničkom stanju tako da osigura tačnost merenja;</p> <p>1.3.dostavlja merila u upotrebi za overavanje, u skladu sa ovim zakonom;</p> <p>1.4.koristi zakonske merila u skladu sa njihovom namenom;</p> <p>1.5.vodi evidenciju o održavanju i overavanju zakonskih merila u upotrebi, kada je ovo utvrđeno.</p> <p>2.Zakonski merila koji nije u upotrebi treba da bude vidljivo označen oznakom „Merila van upotrebe“</p>

<p align="center"><b>Neni 24</b> <b>Verifikimi pasues i mjeteve matëse ligjërisht të kontrolluara</b></p>	<p align="center"><b>Article 24</b> <b>Subsequent verification of legally controlled measuring instruments</b></p>	<p align="center"><b>Član 24</b> <b>Naknadno overavanje zakonski kontrolisanih merila</b></p>
<p>1. Të gjitha mjetet matëse në përdorim duhet të jenë të gjurmueshme deri te etalonët shtetëror, respektivisht etalonët ndërkombëtar, siq është përcaktuar në nenin 13 të këtij ligji.</p> <p>2. Mjetet matëse në përdorim, duhet të plotësojnë kërkesat sipas tipit të miratuar të mjetit matës dhe/ose kërkesat e përcaktuara metrologjike.</p> <p>3. Me miratim të tipit të mjeteve matëse përcaktohet përdorshmëria e mjetit matës, ndërsa përmbushja e kërkesave metrologjike vërtetohet me verifikim.</p> <p>4. Verifikimi i mjeteve matëse ligjërisht të kontrolluara mund të jetë fillestar, pasues/periodik, i kryer në intervale specifike - jo i rregullt dhe i jashtëzakonshëm.</p> <p>5. Përgjegjës për sigurimin e verifikimit të rregullt dhe jo të rregullt të mjetit matës ligjor është vet shfrytëzuesi.</p> <p>6. AMK ose një subjekt juridik i autorizuar është i detyruar të lëshojë certifikatën e</p>	<p>1. All measuring instruments being used shall be traceable up to the national measurement standards, namely international measurement standards, as determined in Article 13 of this Law.</p> <p>2. Measuring instruments in use shall meet the requirements according to the approved type of the measuring instrument and/or determined metrological requirements.</p> <p>3. The approval of the type of measuring instruments determines the usage of measuring instrument, whereas the fulfilment of metrological requirements shall be confirmed with verification.</p> <p>4. Verification of legally controlled measuring instruments may be initial, subsequent/periodic, carried out in specific intervals- not regular and extraordinary.</p> <p>5. The user shall be responsible to ensure regular and non-regular verification of legal measuring instruments.</p> <p>6. KMA or an authorized legal entities shall be obliged to issue the certificate of verification</p>	<p>1.Svi merila koji se koriste treba da budu sledljivi u skladu sa nacionalnim etalonima, odnosno međunarodnim etalonima, kao što je definisano u članu 13. ovog Zakona.</p> <p>2.Merila u upotrebi ispunjavaju zahteve prema odobrenom tipu merila i/ili utvrđenim metrološkim zahtevima.</p> <p>3.Odobrenje tipa merila određuje korišćenje merila, dok se ispunjavanje metroloških zahteva potvrđuje overavanjem.</p> <p>4. Overavanje zakonski kontrolisanih merila može da bude inicijalno, naknadno/periodično, sprovedeno u određenim intervalima – neredovno i vanredno.</p> <p>5.Korisnik je odgovoran da osigura redovno i neredovno overavanje zakonskih merila.</p> <p>6.KAM ili ovlašćeno pravno lice je obavezno da izda uverenje o overavanju na zahtev</p>

<p>verifikimit me kërkesën e aplikantit, edhe nëse mjete matës ka të fiksuar tashmë shenjën e verifikimit.</p> <p>7. Mjetet matëse, të cilat nuk kanë nevojë të verifikohen, duhet të mirëmbahen rregullisht. Procedura, përmbajtja dhe intervalet, kur kryhet mirëmbajtja e rregullt, përcaktohen me akt nënligjor.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 25</b> <b>Verifikimi i rregullt i mjeteve matëse</b></p> <p>1. Verifikimi i rregullt i mjeteve matëse bëhet në afate kohore të përcaktuara, për llojet e caktuara të mjeteve matëse.</p> <p>2. Subjektet juridike të cilët shesin energji termike, energji elektrike, ujë apo gaz dhe të gjithë personat fizik apo juridik që posedojnë mjete matëse ligjore, janë të detyruar të përkujdesen për verifikim të rregullt të mjeteve matëse të energjisë termike, matësit e gazit, matësit e ujit dhe matësit e energjisë elektrike.</p> <p>3. Me akt nënligjor përcaktohen mënyrat dhe afatet e verifikimit të rregullt të mjeteve matëse.</p>	<p>upon the request of the applicant, even if the measuring instrument already has a verification mark affixed.</p> <p>7. Measuring instruments, which do not need to be verified, shall be regularly maintained. Procedure, content and intervals, after the regular maintenance, shall be determined through a bylaw.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 25</b> <b>Regular verification of measuring instruments</b></p> <p>1. Regular verification of measuring instruments shall be carried out within set deadlines for certain types of measuring instruments.</p> <p>2. Legal entities who sell thermal energy, electricity, water or gas, and all natural or legal persons possessing legal measuring instruments are obliged to take care about regular verification of measuring instruments of thermal energy, gas meter, water meter and electricity meter.</p> <p>3. Manners and deadlines for regular verification of measuring instruments shall be determined with a bylaw.</p>	<p>podnosioca zahteva, čak i ako merila ima postavljen oznaku o overavanju.</p> <p>7. Merila, koji ne moraju da budu overeni, ipak se moraju održavati redovno. Procedure, sadržaj i intervali, nakon redovnog održavanja, treba da budu određeni kroz podzakonske akte.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 25</b> <b>Redovno overavanje merila</b></p> <p>1. Redovno overavanje merilase vrši u okviru utvrđenih rokova za određene vrste merila.</p> <p>2. Pravna lica koja prodaju toplotnu energiju, električnu energiju, vodu ili gas, i sva fizička i pravna lica koja poseduju zakonske merila su obavezna da vode računa o redovnom overavanju merilatoplotne energije, gasometra, vodomera i strujomera.</p> <p>3. Način i rokovi redovnog overavanja merila se utvrđuju podzakonskim aktom.</p>
---	--	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 26</b> <b>Verifikimi jo i rregullt i mjeteve matëse</b></p> <p>Verifikimi jo i rregullt i mjeteve matëse bëhet në rastet kur mjete matës ligjor nuk ka qenë në përdorim për shkak të defektit apo mangësive teknike, pas riparimit ose në rastin kur mjete nuk i është nënshtruar verifikimit të rregullt në afat kohor të paraparë.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 26</b> <b>Non-regular verification of measuring instruments</b></p> <p>Non-regular verification of measuring instruments shall be made in cases when the legal measuring instrument was not being used due to the defect or technical shortcoming, following the repairing in the case when the instrument has not been subject to the regular verification within the set deadline.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 26</b> <b>Neredovno overavanje merila</b></p> <p>Neredovno overavanje merila se vrši u slučajevima kada se zakonski merila ne koristi zbog kvara ili tehničke mane, nakon popravke ili u slučaju kada je merila predmet redovnog overavanja u okviru utvrđenog roka.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 27</b> <b>Verifikimi i jashtëzakonshëm i mjeteve matëse</b></p> <p>1.Verifikimi i jashtëzakonshëm i mjeteve matëse dhe kontrolli i matjeve zyrtare bëhet me ekspertizë metrologjike kur ka dyshime për keqfunksionimin e mjeteve matëse ligjore.</p> <p>2. Kërkesën për verifikim të jashtëzakonshëm të mjeteve matëse ligjore mund ta bëjnë:</p> <p style="margin-left: 40px;">2.1.Institucionet relevante që merren me mbikëqyrjen e tregut dhe mjeteve matëse që gjenden në treg;</p> <p style="margin-left: 40px;">2.2. Subjekti juridik/pronari i mjeteve matëse;</p> <p style="margin-left: 40px;">2.3. Përdoruesit e mjeteve matëse; dhe</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 27</b> <b>Extraordinary verification of measuring Instruments</b></p> <p>1. Extraordinary verification of measuring instruments and check of the official measurements shall be madewith metrological expertise when there are doubts for malfunctioning of legal measuring instruments.</p> <p>2. The request for extraordinary verification of legal measuring instruments may be filed by:</p> <p style="margin-left: 40px;">2.1. Relevant institutions supervising the market and measuring instruments in the marked;</p> <p style="margin-left: 40px;">2.2. Legal entitie/owner of measuring instruments;</p> <p style="margin-left: 40px;">2.3. Users of measuring instruments; and</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 27</b> <b>Vanredno overavanje merila</b></p> <p>1.Vanredno overavanje merila i provera zvaničnih merenja se vrši metrološkom ekspertizom kada postoje sumnje da postoji kvar zakonskog merila.</p> <p>2.Zahtev za vanredno overavanje zakonskih merila mogu podneti:</p> <p style="margin-left: 40px;">2.1.Relevantne institucije koje vrše nadzor nad tržištem i merila na tržištu;</p> <p style="margin-left: 40px;">2.2. Pravna lica/vlasnici merila;</p> <p style="margin-left: 40px;">2.3Korisnici merila; i</p>

<p>2.4. Konsumatorët të cilët konsiderojnë se janë dëmtuar nga mjetet matëse ligjore.</p> <p>3. Me akt nënligjor përcaktohet procedura e verifikimit të jashtëzakonshëm dhe shpenzimet që dalin nga verifikimi i jashtëzakonshëm i mjeteve matëse dhe matjeve zyrtare .</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 28</b> <b>Vlefshmëria e verifikimit të mjeteve matëse</b></p> <p>1. Vlefshmëria e verifikimit të mjeteve matëse ligjore ndërpritet nëse:</p> <p>1.1. ka skaduar validiteti i verifikimit;</p> <p>1.2. në mjetin matës janë bërë ndryshime të cilat mund të ndikojnë në karakteristikat metrologjike të tij;</p> <p>1.3. mjeti matës është dëmtuar në atë mënyrë që ka mund të humbë ndonjë veti të rëndësishme që është objekt i verifikimit;</p> <p>1.4. shenja e verifikimit është dëmtuar;</p> <p>1.5. shihet qartë se mjeti matës ka humbur vetitë e nevojshme metrologjike edhe nëse shenja e verifikimit nuk është e dëmtuar;</p> <p>1.6. vendi i instalimit të mjeteve matëse është ndryshuar.</p>	<p>2.4. Consumer who consider that they have been damaged from legal measuring instruments.</p> <p>3. Procedure of extraordinary verification and the expenditures deriving from the extraordinary verification of measuring instruments and official measurements shall be determined with a bylaw.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 28</b> <b>Validity of verification of measuring instruments</b></p> <p>1. Validity of verification of measuring instruments shall be discontinued if:</p> <p>1.1. verification validity has expired;</p> <p>1.2. changes have been applied to the measuring instrument which can impact its metrological characteristics;</p> <p>1.3. measuring instrument has been damaged in that way that may lose any important property that is subject of verification;</p> <p>1.4. verification mark has been damaged;</p> <p>1.5. it is clearly seen that the measuring instrument has lost necessary metrological properties even if the verification mark has not been damaged;</p> <p>1.6. the place for installation of measuring instruments has changed.</p>	<p>2.4. Potrošači koji smatraju da im je učinjena šteta zakonskim merila.</p> <p>3. Procedure vanrednog overavanja i troškove koji proizilaze iz vanrednih overavanja merila i zvaničnih merenja se utvrđuju podzakonskim aktom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 28</b> <b>Važenje overe merila</b></p> <p>1. Važenje overe merila prestaje, ako je:</p> <p>1.1. istekao rok važenja overe;</p> <p>1.2. na merila izvršena promena koja može uticati na njegove metrološke karakteristike;</p> <p>1.3. merila oštećen na takav način da je mogao izgubiti neko svojstvo bitno za overavanje;</p> <p>1.4. oznaka o overavanju oštećen;</p> <p>1.5. merila očigledno izgubio potrebna metrološka svojstva čak i ako oznaka o overavanju nije oštećena;</p> <p>1.6. Mesto instalacije merila promenjeno.</p>
--	---	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 29</b> <b>Etalonet e matjeve dhe materialet referente në metrologjinë ligjore</b></p> <p>1. Për verifikimin e mjeteve matëse ligjërisht të kontrolluara duhet të përdoren vetëm etalone matjeje të kalibruara, që kanë certifikatë kalibrimi të vlefshme dhe materiale referente të certifikuara, që kanë certifikatë materiali referent të vlefshëm.</p> <p>2. Kalibrimi i etaloneve të matjeve dhe certifikimi i materialeve referente, që përdoren për verifikimin e mjeteve matëse ligjërisht të kontrolluara, kryhet nga AMK apo nga laborator kalibrimi/testimi të akredituar.</p> <p>3. Drejtori i Përgjithshëm i AMK-së rekomandon intervalet maksimale të kalibrimit për etalonët e matjes, që përdoren për verifikimin e mjeteve matëse ligjërisht të kontrolluara.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 29</b> <b>Measurement standards and reference materials in the legal metrology</b></p> <p>1. For verification of legally controlled measuring instruments should be used only calibrated measurements standards that have valid calibration certificate and certified reference material that have valid reference material certificate.</p> <p>2. Calibration of measurement standards and certification of reference materials that are used for verification of legally controlled measuring instruments shall be carried out by KMA or accredited calibration/testing laboratories.</p> <p>3. Director General of KMA shall recommend maximum recalibration intervals for measurement standards used for verification of legally controlled measuring instruments.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 29</b> <b>Etaloni i referentni materijali u zakonskoj metrologiji</b></p> <p>1. Za overu zakonski kontrolisanih merila treba da se koriste samo kalibrisani etaloni koji imaju važeće uverenje o kalibraciji i sertifikovani referentni materijal koji ima važeće uverenje o referentnom materijalu.</p> <p>2. Kalibraciju etalona i sertifikaciju referentnog materijala koji se koriste za overavanje zakonski kontrolisanih merila vrši KAM ili akreditovana laboratorija za kalibraciju/testiranje.</p> <p>3. Generalni direktor KAM-a preporučuje maksimalne intervale ponovne kalibracije za etalone koji se koriste za overavanje zakonski kontrolisanih merila.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 30</b> <b>Parapaketimet</b></p> <p>1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për parapaketimet individuale, të kombinuara, pa ambalazh mbështjellës dhe në enë matëse, që janë prodhuar, hedhur në treg ose ofruar për konsum të përgjithshëm.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 30</b> <b>Pre-packages</b></p> <p>1. The provisions of this law shall apply for individual, combined packages without wrapping package and in measuring containers, which have been produced, placed</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 30</b> <b>Prethodno upakovani proizvodi</b></p> <p>1. Odredbe ovog zakona se primenjuju na pojedinačna, kombinovana pakovanja bez omota i u mernim posudama, koje su proizvedene, plasirane na tržište ili stavljene na raspolaganju za opštu potrošnju.</p>



<p>2. Produktet e parapaketuara në kuptim të këtij ligji nuk konsiderohen mostrat falas, të cilat janë si produkte të parapaketuara, e të cilat përdoren për qëllime të marketingut.</p> <p>3. Me akt nënligjor përcaktohen kriteret dhe masat e përgjithshme për parapaketimet që kontrollohen ligjërisht, kërkesat metrologjike për sasinë neto të parapaketimeve, diapazonet e detyrueshme për sasinë nominale të disa parapaketimeve, metodat referuese për kontrollin e sasisë neto të parapaketimeve, mbishkrimet dhe shenjat e vendosura në parapaketime.</p>	<p>on the market or provided for general consumption.</p> <p>2. Pre-packaged products within the meaning of this law shall not be considered free samples, which are pre-packaged products used for marketing purposes.</p> <p>3. Criteria and general measures for legally controlled pre-packages, metrological requirements for net quantity of pre-packages, mandatory ranges for the nominal amount of several pre-packages, referring methods for controlling net quantity of pre-packages, inscriptions and marks affixed in pre-packages shall be determined with a bylaw.</p>	<p>2.Prethodno upakovani proizvodi, u smislu ovog zakona, se ne smatraju besplatnim uzorcima, što su prethodno upakovani proizvodi koji se koriste u marketinške svrhe.</p> <p>3.Kriterijumi i opšte mere za zakonski kontrolisane prethodno upakovane proizvode, metrološki zahtevi za neto količinu prethodno upakovanih proizvoda, zakonski opseg za nominalnu količinu od nekoliko prethodno upakovanih proizvoda, metode upućivanja za kontrolisanje neto količine prethodno upakovanih proizvoda, natpisi i oznake postavljeni na prethodno upakovane proizvode treba da budu utvrđeni podzakonskim aktom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 31</b> <b>Shishet si enë matëse</b></p> <p>1. Shishet si enë matëse përmbajnë shenjat që tregojnë vëllimin nominal dhe atë të mbushjes deri në nivelin e plotë si dhe me shenjën që identifikon prodhuesin e enës matëse.</p> <p>2. Me akt nënligjor përcaktohen shishet që kontrollohen ligjërisht, kërkesat metrologjike për shishet si enë matëse, metodat referuese për kontrollin e vëllimit neto të shisheve,</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 31</b> <b>Measuring Container Bottles</b></p> <p>1.Measuring container bottles shall contain marks indicating the nominal and filling volume to the complete level, as well as the mark identifying the manufacturer of measuring container.</p> <p>2. The bylaw defines the bottles that are legally controlled, metrological requirements for measuring container bottles, referring methods for the control of net volume of bottles,</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 31</b> <b>Boce kao merne posude</b></p> <p>1.Boce kao merne posude sadrže oznake koje ukazuju na nominalnu i zapreminu punjenja do potpunog nivoa, kao i oznaku koja identifikuje proizvođača merne posude.</p> <p>2.Podzakonski akti definišu boce koje su zakonski kontrolisane, metrološke zahteve za boce kao merne posude, metode upućivanja za kontrolu neto zapremine boce, natpisa i oznaka</p>

<p>mbishkrimet dhe shenjat e vendosura në shisheet si enë matëse.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 32</b> <b>Vendosja në treg e parapaketimeve dhe e shisheve si enë matëse</b></p> <p>1. Mallrat e parapaketuara dhe shisheet si enë matëse, mund të vendosen në treg, vetëm nëse plotësojnë kërkesat metrologjike të përcaktuara me këtë ligj dhe kanë mbishkrimet dhe shenjat e përshkruara deri në kohën e blerjes.</p> <p>2. Prodhuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar ose importuesi është përgjegjës për përputhshmërinë e produkteve të parapaketuara dhe të shisheve si enë matëse, me masat e përcaktuara në këtë ligj.</p> <p>3. Prodhuesi zbaton sistemin e tij të kontrollit të sasisë neto të parapaketimeve ose sistemin e kontrollit të vëllimit neto të shisheve si enë matëse të prodhuara.</p> <p>4. Prodhuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar ose importuesi është i detyruar të njoftojë AMK-në kur konstaton se parapaketimet ose shisheet si enë matëse, të vendosura në treg nga ai, nuk përmbushin kërkesat metrologjike në mënyrë që të merren masat e duhura për mbrojtjen e konsumatorit.</p>	<p>inscriptions and marks affixed on the measuring container bottles.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 32</b> <b>Placing on the market the pre-packages and measuring containers bottles</b></p> <p>1. Pre-packaged goods and measuring containers bottles may be placed on the market only if they meet the metrological requirements determined by this law and shall have the inscriptions and marks described up to the time of purchase.</p> <p>2. Manufacturer, his authorized representative or importer shall be responsible for the compliance of the pre-packaged products and measuring bottles with measures determined in this law.</p> <p>3. Manufacturer shall apply his net quantity control system for pre-packages or control system for the net volume as manufactured measuring container bottles.</p> <p>4. Manufacturer, his authorized representative or importer shall be obliged to inform KMA when finding that pre-packages or measuring containers bottles placed on the market by him do not fulfil the metrological requirements in order to take appropriate measure for consumer protection.</p>	<p>postavljenih na boce koje služe kao merne posude.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 32</b> <b>Plasiranje na tržište prethodno upakovanih proizvoda i boca kao mernih posuda</b></p> <p>1. Prethodno upakovana roba i boce kao merne posude mogu biti plasirane na tržište samo ako ispunjavaju metrološke zahteve utvrđene ovim zakonom i imaju natpise i oznake opisane do vremena kupovine.</p> <p>2. Proizvođač, njegov ovlašćeni predstavnik ili uvoznik su odgovorni za usklađivanje prethodno upakovanih proizvoda i mernih boca sa merama utvrđenim u ovom zakonu.</p> <p>3. Proizvođač primenjuje svoj sistem kontrole neto količine za prethodno upakovane proizvode ili sistem kontrole za neto zapreminu kao proizvođač boca koje služe kao merne posude.</p> <p>4. Proizvođač, njegov ovlašćeni predstavnik ili uvoznik su obavezni da obaveste KAM kada otkriju da prethodno upakovani proizvodi ili boce kao merne posude koje je on plasirao na tržište ne ispunjavaju metrološke zahteve u cilju preduzimanja odgovarajućih mera za zaštitu potrošača.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 33</b> <b>Regjistrimi i prodhuesve dhe i importuesve</b></p> <p>1. Regjistrimi i prodhuesve dhe i importuesve bëhet në bazë të kërkesës së tyre në AMK.</p> <p>2. Mënyra dhe procedura e regjistrimit përcaktohet me akt nënligjor.</p> <p>3. Prodhuesit dhe importuesit detyrohen të njoftojnë AMK-në për çdo ndryshim të kryer pas regjistrimit.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 33</b> <b>Registration of manufacturers and importers</b></p> <p>1. Registration of manufacturers and importers shall be made based on their request to KMA.</p> <p>2. Manner and procedure for registration shall be determined through a bylaw.</p> <p>3. Manufacturers and importers shall be obliged to inform KMA for any change following the registration.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 33</b> <b>Registracija proizvođača i uvoznika</b></p> <p>1.Registracija proizvođača i uvoznika se vrši na osnovu njihovog zahteva dostavljenog KAM-u.</p> <p>2.Naçin i procedura registracije se utvrđuju podzakonskim aktom.</p> <p>3.Proizvođači i uvoznici su obavezni da obaveste KAM o svim promenama nakon registracije.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 34</b> <b>Miratimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve</b></p> <p>1. AMK kryen mbikëqyrjen në vend të sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve si dhe monitoron sistemin e kontrollit sasior të miratuar në kushtet e prodhuesit dhe në qoftë se është e nevojshme jep rekomandime për përmirësimin e tij.</p> <p>2. Çdo prodhues është i obliguar që të marrë miratimin e AMK-së për sistemin e kontrollit sasior.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 34</b> <b>Approval and monitoring of quantity control system of pre-package manufacturers</b></p> <p>1. KMA shall conduct on-site supervisions of quantity control system of manufacturers, as well as shall monitor the quantity control system approved in the conditions of the manufacturer and if necessary provide recommendations.</p> <p>2. Every manufacturer shall be obliged to obtain the approval of KMA for quantity control system.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 34</b> <b>Odobranje i praćenje sistema za kontrolu količine proizvođača prethodno upakovanih proizvoda</b></p> <p>1.KAM na licu mesta vrši nadzor sistema za kontrolu količine proizvođača, takođe prati odobreni sistem za kontrolu količine u uslovima proizvođača i ako je potrebno daje preporuke.</p> <p>2. Svaki proizvođač je obavezan da dobije odobrenje KAM-a za sistem za kontrolu količine.</p>

<p>3. Regjistrimi i prodhuesve bëhet dhe ruhet vetëm nëse sistemi i tij i kontrollit sasior është miratuar.</p> <p>4. AMK mund të njoh konformitetin e dispozitave shtetërore të parapaketimeve dhe SHEM që i bartin shenjat e konformitetit të ngjitura sipas rregulloreve ligjore të metrologjisë së shteteve tjera ose sipas sistemeve të shënimit të konformitetit të krijuara nga trupat tjerë ndërkombëtarë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 35</b> <b>Aktet nënligjore të zbatueshme për fushat e interesit të posaçëm të qeverisë</b></p> <p>1.Ky nen është i aplikueshëm - vetëm në rast se ka produkte me interes për disa fusha të rëndësishme për tregtinë e vendit, prodhimin ose pasurinë.</p> <p>2.Ministria do t'i identifikojë fushat në të cilat duhet të hartohen aktet nënligjore si në vijim:</p> <p>2.1.Rregullorja për mjetet matëse; 2.2.Rregullorja për peshoret jo-automatike; 2.3.Rregullorja për produktet e para-paketuara; 2.4.Rregullorja për shishet si enë matëse.</p>	<p>3. Manufacturers shall be registered and retained only if his quantity control system has been approved.</p> <p>4. KMA, may recognize the conformity of state provisions of pre-packages and MCB that hold conformity marks affixed in compliance with the legal metrology regulations of other states or according to conformity marking systems created by other international bodies.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 35</b> <b>Applicable sub-laws for special interest of Government</b></p> <p>1. This Article shall be applicable only in cases there are products of interest for several important fields for the trade, manufacturing or assets of the country.</p> <p>2.Ministry shall identify fields in which regulations should be drafted, as follows:</p> <p>Regulation on Measuring Instruments; Regulation on Non-Automatic Weights; Regulation for Pre-packaged Products; Regulation for Measuring Container Bottles.</p>	<p>3.Proizvođači se registruju i zadržavaju registraciju samo ako je njihov sistem za kontrolu količine odobren.</p> <p>4.KAM, može da prepozna usklađenost državnih odredbi o prethodno upakovanim proizvodima i BMP-u koji nose oznaku usklađenosti postavljenu u skladu sa zakonskim propisima o metrologiji druge države ili u skladu sa sistemom označavanja usklađenosti kreiranog od strane drugih međunarodnih tela.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 35</b> <b>Važeći podzakonski akti od posebnog značaja za Vladu</b></p> <p>1.Ovaj član važi samo u slučajevima kada postoje proizvodi od značaja za nekoliko značajnih oblasti za trgovinu, proizvodnju ili imovinu zemlje.</p> <p>2.Ministarstvo određuje oblasti u kojima uredbe treba da budu izrađene, i to:</p> <p>Uredba o merila; Uredba o ne-automatskim vaga; Uredba o prethodno upakovanim proizvodima; Uredba o bocama kao mernim posudama.</p>
--	---	---

<p align="center"><b>Neni 36</b> <b>Trupat e autorizuar për vlerësimin e konformitetit</b></p>	<p align="center"><b>Article 36</b> <b>Designated conformity assessment bodies</b></p>	<p align="center"><b>Član 36</b> <b>Imenovana tela za procenu usklađenosti</b></p>
<p>1.Kur një trup për vlerësimin e konformitetit demonstroi konformitetin e tij me kriteret e caktuara me aktet nënligjore në fuqi, standardet dhe udhëzimet, vërtetohet se është në përputhshmëri me dispozitat e aplikueshme të këtij Ligji.</p> <p>2.Për zbatimin e këtij Ligji, Ministria përmes akteve nënligjore duhet të kërkojë që trupat për vlerësimin e konformitetit që janë përgjegjës për fushat e aplikueshme të metrologjisë ligjore të jenë të akredituar.</p> <p>3.Ministria me aktin nënligjor përkatës për mënyrën e autorizimit për trupat për vlerësim të konformitetit, rregullon procedurat e vlerësimit për të autorizuar trupat për vlerësimin e konformitetit në fushat specifike të metrologjisë ligjore.</p> <p>4.Trupat e autorizuar për vlerësimin e konformitetit mirëmbajnë bazën e të dhënave bashkë me regjistrat relevant për mjetet matëse që i janë nënshtruar punës së kontrollit metrologjik ligjor në pajtueshmëri me kompetencën e tyre.</p>	<p>1. When a conformity assessment body demonstrates its conformity with the criteria determined in applicable bylaws, standards and guidelines, it proves that it complies with applicable provisions of this Law.</p> <p>2. For the implementation of this Law, the Ministry, through bylaws, shall require that conformity assessment bodies that are responsible for applicable fields of legal metrology be accredited.</p> <p>3.Ministry, through a relevant bylaw on the manner of designation for conformity assessment bodies, shall regulate the assessment procedures to designate conformity assessment bodies in specific fields of legal metrology.</p> <p>4.Designated conformity assessment bodies shall maintain the database along with the relevant registers for measuring instruments that have been subject to the legal metrological control in compliance with their competence.</p>	<p>1.Kada tela za procenu usklađenosti dokažu svoju usklađenost sa kriterijumima određenim u važećim podzakonskim aktima, standardima i smernicama, to pokazuje da su u skladu sa važećim odredbama ovog zakona.</p> <p>2.Za sprovođenje ovog zakona, Ministarstvo, kroz podzakonske akte, zahteva da tela za procenu usklađenosti koja su odgovorna za važeće oblasti zakonske metrologije budu akreditovana.</p> <p>3.Ministarstvo, kroz relevantan podzakonski akt o načinu imenovanja tela za procenu usklađenosti, reguliše procedure procene imenovanja tela za procenu usklađenosti u određenim oblastima zakonske metrologije.</p> <p>4.Imenovana tela za procenu usklađenosti održavaju bazu podataka zajedno sa relevantnim registrom za merila koji su predmet zakonske metrološke kontrole u skladu sa njihovim nadležnostima.</p>

<p>5.Trupat e autorizuar për vlerësimin e konformitetit marrin obligimin që të sigurojnë për dëmet e shkaktuara ndaj palëve të treta në lidhje me aktivitetet e vlerësimit të konformitetit të mjeteve matëse.</p> <p>6. Procedurat për organizimin dhe mënyrën se si ushtrohet kontrolli ligjor metrologjik për trupat e autorizuar për vlerësim të konformitetit, përcaktohet me akt nënligjor për mbikëqyrjen metrologjike, i cili nxirret nga Ministria.</p> <p>7.Kërkesat e aplikueshme për trupat e vlerësimit të konformitetit që ofrojnë shërbime të vlerësimit të konformitetit për fushën e metrologjisë ligjore, përcaktohen me akte nënligjore të cilat i nxjerrë Ministria, në përputhshmëri me Standardet e aplikuar.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 37</b> <b>Autorizimi i subjektit juridik për riparimin dhe përgatitjen e mjeteve matëse për verifikim</b></p> <p>1.Drejtori i Përgjithshëm i AMK-së mund të autorizon operatorin ekonomik i cili plotëson kushtet për kryerjen e riparimit dhe përgatitjen e mjeteve matëse ligjore për verifikim.</p>	<p>5.Designated conformity assessment bodies shall assume the obligation to ensure the damages caused against third parties in regards to the activities for assessing conformity of measuring instruments.</p> <p>6. Procedures for organization and manner on how to perform the legal metrological control for designated conformity assessment bodies shall be determined through a bylaw for metrological supervision that will be issued by the Ministry.</p> <p>7.Applicable requirements for conformity assessment bodies that provide services of conformity assessment for the field of legal metrology shall be determined with bylaws that will be issued by the Ministry, in compliance with the applicable standards.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 37</b> <b>Authorization of legal entity for repair and preparation of measuring instruments for verification</b></p> <p>1. The General Director of KMA may authorize economic operator who meets the conditions for carrying out repair and preparation of legal measuring instruments for verification.</p>	<p>5.Imenovana tela za procenu usklađenosti preuzimaju obavezu da osiguraju oštećenja prouzrokovana trećim stranama u vezi sa aktivnostima za procenu usklađenosti merila.</p> <p>6.Procedure za organizaciju i način vršenja zakonske metrološke kontrole za imenovana tela za procenu usklađenosti se utvrđuju podzakonskim aktom o metrološkom nadzoru koji donosi Ministarstvo.</p> <p>7.Važeći zahtevi za tela za procenu usklađenosti koja pružaju usluge procene usklađenosti za oblasti zakonske metrologije se utvrđuju podzakonskim aktima koje donosi Ministarstvo, u skladu sa važećim standardima.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 37</b> <b>Ovlašćivanje pravnog lica za popravke i pripremu merilaza overavanje</b></p> <p>1.Generalni direktor KAM-a može da ovlasti ekonomskog operatera koji ispunjava uslove za vršenje popravke i pripremu zakonskih merila za overavanje.</p>
---	--	---

<p>2. Subjekti juridik i autorizuar i cili bën riparimin dhe përgatitjen e mjeteve matëse për verifikim sipas paragrafit 1 të këtij neni, nuk mund të kryej verifikimin e mjeteve matëse.</p> <p>3. Autorizimi mund t'i jepet operatorit ekonomik nëse:</p> <p>3.1. posedon pajisje të nevojshme teknike dhe hapësirë për të kryer aktivitete për të cilat kërkohet autorizimi;</p> <p>3.2. ka siguruar gjurmueshmërinë e etalonëve dhe mjeteve matëse të cilat i përdorë,</p> <p>3.3. punëson persona profesionalisht të aftësuar, për kryerjen e detyrave të parapara me autorizim;</p> <p>3.4. jep garancion për kompensimin e dëmeve të shkaktuara me punën e tyre, dhe</p> <p>3.5. nuk është në procedurë të falimentimit.</p> <p>4. Me akt nënligjor përcaktohen kushtet dhe kriteret tekniko-metrologjike për autorizimin e subjektit juridik për kryerjen e veprimtarive për shërbimin e riparimit dhe përgatitjen e mjeteve matëse për verifikim.</p>	<p>2. The authorized legal entity who does the repair and preparation of measuring instruments for verification pursuant to paragraph 1 of this Article cannot perform verification of measuring instruments.</p> <p>3. The authorization may be granted if the economic operator:</p> <p>3.1. possesses necessary technical equipment and space to perform activities that require authorization;</p> <p>3.2. has ensured traceability of the measurement standards and measuring instruments that are used,</p> <p>3.3. employs professionally trained persons to perform the tasks provided by the authorization;</p> <p>3.4. guarantees for compensation of damages incurred by their work, and</p> <p>3.5. is not undergoing bankruptcy procedure.</p> <p>4. Through bylaw are determined technical metrological conditions and criteria for authorization of legal entity to perform activities for repairing services and preparation of measuring instruments for verification.</p>	<p>2.Ovlaščeno pravno lice koje vrši popravku i pripremu merila za overavanje u skladu sa stavom 1. ovog člana ne može da vrši overavanje merila.</p> <p>3.Ovlašćenje se može dati ako ekonomski operater:</p> <p>3.1. poseduje potrebnu tehničku opremu i prostor za vršenje aktivnosti koje zahtevaju ovlašćenje;</p> <p>3.2.osigurao sledljivost etalona i merilakoji su u upotrebi;</p> <p>3.3. zapošljava stručno obučeno osoblje da vrši zadatke predviđene ovlašćenjem;</p> <p>3.4. garantuje naknadu za štetu nastalu njihovim radom, i</p> <p>3.5. nije u stečaju.</p> <p>4.Kroz podzakonski akt su utvrđeni tehnički metrološki uslovi i kriterijumi za ovlašćivanje pravnih lica da vrše aktivnosti usluga popravke i pripreme merila za overavanje.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 38</b> <b>Afati për lëshimin e autorizimit</b></p> <p>1. Për autorizimin nga neni 37 i këtij ligji, në afat prej tridhjetë (30) ditë, nga dita e parashtrimit të kërkesës, Drejtori i Përgjithshëm i AMK-së lëshon vendimin për autorizim.</p> <p>2. Me vendim për autorizimin, përcaktohet fusha dhe vëllimi i autorizimit.</p> <p>3. Autorizimi vlen tri (3) vite.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 38</b> <b>Timeline for issuing the authorization</b></p> <p>1. For authorization under Article 37 of this Law, within thirty (30) days from the date of submitting the application, the General Director of KMA shall issue the decision for authorization.</p> <p>2. The decision for authorization determines the field and volume of authorization.</p> <p>3. Authorization is valid for three (3) years.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 38</b> <b>Rok za izdavanje ovlaštenja</b></p> <p>1. Za ovlašćivanje prema članu 37. ovog Zakona, generalni direktor KAM-a izdaje odluku o ovlašćenju u roku od trideset (30) dana od datuma dostavljanja zahteva.</p> <p>2. Odluka o ovlašćenju određuje oblast i obim ovlašćenja.</p> <p>3. Ovlašćenje važi tri (3) godine.</p>
